

Arsimi dhe formimi profesional për të rriturit

Bashkohuni me komunitetin e EPALE të përbërë nga më shumë se 30 000 profesionistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!

Të dashur kolegë të EPALE,



Fokusi ynë tematik për muajin nëntor ishte [arsimi dhe formimi profesional \(AFP\) për të rriturit](#). Në nderim të [Javës së Aftësive Profesionale](#), ekipet kombëtare dhe komuniteti i EPALE publikuan një numër rastesh studimore, artikujsh, raportesh dhe burimesh të tjera frymëzuese. Ju mund t'i gjeni ato në faqen tonë të posaçme [Sipërmarrja dhe punësueshmëria](#) (përmbajtja ndryshon sipas versionit gjuhësor).

Më 30 nëntor ne organizuam një diskutim në internet, të moderuar nga [Andrew McCoshan](#), në lidhje me aftësitë profesionale që ju nevojiten të rriturve sot si edhe me sfidat me të cilat ato përballen gjatë përfundimit të tyre. Diskutimi i thellë u përqëndrua në një numër çështjesh të tilla si mënyra se si AFP për të rriturit po përshtatet me ndryshimet në fuqinë punëtore dhe mënyrën se si AFP ofron aftësi të përditësuara për nxënësit.

Nëse e keni humbur diskutimin, mos u shqetësoni - [ju mund t'i shikoni komentet dhe temat e diskutuara këtu](#) (në gjuhën angleze).

[Shihni një përmbledhje të fokusit të EPALE gjatë muajit nëntor të përgatitur nga Koordinatorja Tematike Gina Ebner.] (në gjuhën angleze)

Postime në formë blogu

Podcast-i i EPALE: Arsimi dhe formimi profesional për të rriturit në vitin 2017

Duke e ruajtur fokusin tonë tek AFP, Koordinatorët tanë Tematikë, [Andrew McCoshan](#), [David Mallows](#), [Gina Ebner](#), [Markus Palmen](#) dhe [Simon Broek](#) u mblodhën së bashku për të diskutuar sfidat e zbatimit të AFP-së në të gjithë Europën.

Politika e arsimit dhe formimit profesional ka nevojë për ndërgjegjësimin e palëve të interesuara

Shikoni mendimet e [Markus Palmen](#) për ruajtjen e arsimit në AFP brenda Europës dhe për shembullin pozitiv që mund të jepet nga reforma e ardhshme e AFP në Finlandë. (në gjuhën angleze)

Arsimi dhe formimi profesional zhvillon komunitetet lokale në Gjeorgji

Lexoni se si një qendër arsimore për të rriturit në Gjeorgji u bë pjesë integrale për zhvillimin e komunitetit të saj lokal paketave të ndryshme mësimore për të rriturit si edhe nëpërmjet kurseve të formimit profesional.

Rëndësia e kualifikimeve të tranzicionit për të rriturit

Koordinatori Tematik i EPALE, [Simon Broek](#), ka reflektuar në lidhje me rëndësinë e kualifikimeve të tranzicionit për të rriturit dhe me atë që ka mësuar nga seminari i parë i CHAIN 5 për kualifikimet e nivelit 5 të KEK.

Lajme nga mbarë Europa



Muaji nëntori vazhdoi të ishte një muaj i ngarkuar me aktivitete për sektorin e të nxënësve për të rritur në të gjithë Europën:

- Janë hapur nominimet për Çmimet *Inspire!* (Frymëzo!) për vitin 2018, të koordinuara nga Instituti për Mësimin dhe Punën dhe në partneritet me Qeverinë e Uellsit (në gjuhën angleze).
- Estelle Sauvat u emërua Komisionere e Lartë e Francës për Transformimin e Aftësive (në gjuhën frënge).
- Më shumë se 100 të ftuar nga komuniteti i arsimit për të rritur u mbledhën për të parë se cilat organizata ishin nderuar me çmime në Ceremoninë e Çmimeve të Shtetit Austriak për Arsimin e të Rriturve (në gjuhën gjermane).

Bashkohuni tani!

Mos harroni të regjistroheshi në EPALE për të shkëmbyer mendimet tuaja në këto postime. Bashkohuni tani dhe bëhuni pjesë e komunitetit me më shumë se 30 000 profesionistë të të nxënësve për të rritur.